



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 21-465
Datë 16-11-2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, prej 31. 10. 2016 deri 31. 10. 2019 për këtë kualifikim të aprovuar:

1.1. Auditor i brendshëm në sektorin privat dhe publik, niveli i KKK-së (V).

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Planifikimi financiar për tre vitet e ardhshme.
- Plani i angazhimit të ligjëruesve të rregullt.
- Personave me nevoja të veçanta t'iu mundësohet një qasje e arsyeshme në certifikim.

(Afati kohor: 15. 01. 2017).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 31.10.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacionet për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucion Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.
4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.
5. Vendimi i dërgohet:
 - Institutit për Kontabilitet, Auditim dhe Financa në Prishtinë; dhe
 - AKK.



Nën-kryetari i KD së AKK
Anton Gojani